VENDIM
NR. 844, datë 24.12.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA GJIROKASTËR, TË PRONËS NR. 599, ME EMËRTIM "AERODROM FUSHOR", ME VENDNDODHJE NË GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gjirokastër, të pronës nr. 599, me emërtim "Aerodrom fushor", me vendndodhje në Gjirokastër, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 599, me emërtim "Aerodrom fushor", me vendndodhje në Gjirokastër, sipas planrilevimit, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Gjirokastër.
3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Gjirokastër dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI

Prona nr.599 "Aerodromi fushor " Gjirokastër

MIRATOHET
Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore
Kolonel - EDITSON ZARKA

PUNOI
Major Arjana SALIKO

Shtator 2019

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. ENEA SINOIMERI

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 1053.
Nr.Pasurise_____Vol.___Fq___
Indeksi i Hartes BR;K-34-137-(181-D), K-34-137-(182-C), K-34-137-(198-A)
Shkalla 1: 5000
Adresa e pasurise Gjirokaster
Q/F Gjirokastër.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes,Forca Ajrore



Shpjeguese

Sipërfaqja e përgjithshme = 416652.65 m²

Objekt privat

Kufiri i pronës

Shënim : Ky plan rilevim u hartua në zbatim të shkresës së Forces Ajrore nr 3367/1 datë 18.09.2019,sipas dokumentacionit teknik të kësaj prone të marrë në arkivin e IGJIU,hedhur mbi ortofoton dhe kuadrin e bashkimit të HTR të dhënë nga ZQRPP,Tiranë.Kufiri në terren u hodh në prani të përfaqësuesit të Forcës Ajrore.